


PUNĚ DORE

me FACE



Ndihmoni nxënësit të zhvillojnë kreativitetin e tyre

Të zhvilluarit e aftësive për jetë nuk përfshin vetëm të punuarit me mendje por edhe me duar. Duke bërë diçka vetëm, së bashku me një shok a shoqe apo në grup të vogël, nxënësit përvetësojnë aftësi të rëndësishme si kompetencat e bashkëpunimit dhe komunikimit. Ata po ashtu e zhvillojnë kreativitetin e tyre dhe mund ta përdorin atë në të gjitha fushat mësimore.

FACE (Familjet dhe fëmijët në arsim) i forcon të gjitha format e të mësuarit përmes detyrave dhe bashkëpunimit, duke u përqendruar gjithmonë në produkt konkret. Aktivitetet e ndryshme të punës së dorës po ashtu mbulojnë fusha të ndryshme mësimore dhe mund të aplikohen lehtë në lëndë si edukimi figurativ, matematika, edukata shoqërore, etj.

Është përgjegjësi e mësuesve t'ua përshtasin detyrat kontekstit dhe aftësive të nxënësve.

PËRMBAJTJA

4

Byzylyku i miqësisë

5

Maska qesharake kafshësh

8

Ora e ndjenjave

10

Unë e modeloj shokun apo shoqen time

11

Unë e rindërtoj vendin tim të parapëlqyer

15

Gurët e mi të bukur

16

Piktura e klasës sonë


17

Ne bëjmë një kometë

18






Letra fizarmonikë –
ne jemi njëlloj, ne jemi të ndryshëm

Byzlyku i miqësisë



Ja si mund ta bëni

1. Merrni dy fije leshi dhe prejini nga 50 cm gjatë.
2. Fëmija tjetër le ta mbajë skajin tjetër të fijeve.
3. Dredhni të dyja fijet aq sa mundeni. Mos i lëshoni.
4. Kur të jetë shumë e shtrënguar, vendoseni njërin gisht në mes dhe mbështilleni
5. Fijet do të përdredhen.
6. Bëni nyje në të dyja anët. Byzlyku juaj është i gatshëm!



Maska qesharake kafshësh

1.

Mësuesi shpjegon maska qesharake kafshësh. Tregon shembuj maskash (faqe 6, 7) dhe i lë fëmijët të emërojnë kafshët. Pastaj i inkurajon fëmijët të vendosin cilat maska kafshësh duan t'i bëjnë.

2.

Mësuesi përgatit pjata letre apo karton (të rrumbullakët), bojëra uji, ngjitës dhe gjëra për t'u ngjitur në maskë (penda, letra me ngjyra, lesh, etj.). Ai/ajo po ashtu mund ta shfrytëzojë shabllonin në faqe 6 dhe 7.

3.

Fëmijët punojnë në grupe prej katër vetave me ndihmën e një prindi.

4.

Mësuesi jep udhëzimet në vijim (prindërit ndihmojnë):

- a) Preni maskën (nëse po e përdorni shabllonin)
- b) Vizatoni rrethin për zgavrat e syve
- c) Preni sytë
- d) Ngjyrosni maskën
- e) Dekoroni maskën
- f) Bëni vrimat për spango apo lastik gome
- g) Shkruani emrin tuaj në brendi të maskës

5.



Fëmijët i marrin maskat e mbaruara dhe ulen në rreth së bashku me mësuesin dhe prindërit.

6.





Secili fëmijë mund ta vë maskën e vet.



Maska qesharake kafshësh



Maska qesharake kafshësh



Orë e ndjenjave

1.

Mësuesi e tregon fotografinë e një fëmije duke ngushëlluar një fëmijë tjetër. Pastaj e diskuton atë me fëmijët.

2.

Ai/ajo u paraqet orën e ndjenjave (shablloni, faqe 9). Fëmijët hamendësojnë për ndjenjat (shihe shabllonin).

3.

Me ndihmën e orës, mësuesi u tregon fëmijëve se si ndihet sot. Ai përmbledh një shumëllojshmëri ndjenjash dhe lëviz akrepin e orës derisa flet: "Sot jam i lumtur, sepse moti është i mirë dhe se ju shoh të gjithëve këtu. E dua punën dhe më pëlqen t'ju mësoj. Jam pak i mërzitur, sepse vëllai im jeton larg. Ai jeton në Itali. Gjithashtu, këtë mëngjes qeshë pak i frikësuar sepse hasa në një qen të madh në rrugë. Ai lehu dhe dukej shumë i acaruar."

4.

Më pas fëmijët shkojnë te mësuesi. Lëvizin akrepin e orës dhe thonë se si ndihen.

5.


Nxënësit punojnë individualisht: Ata bëjnë orën e tyre dhe ngjyrosin emocionet e ndryshme me ngjyrat që parapëlqejnë, p.sh. e verdha është lumturi, grija është trishtim, e gjelbra është krenari, etj.

6.

Një fëmijë tregon një ndjenjë në orë dhe tjetri duhet të formojë fjali me të.



Ora e ndjenjave



Unë e modeloj shokun apo shoqen time

1.

Merr një pako plasteline prej mësuesit tënd dhe ndaje me shokun apo shoqen që ke afër.

2.

Do ta modelosh shokun apo shoqen. Cilin shok a shoqe do ta zgjedhësh? Si duket ai/ajo?

3.

Fillo modelimin pjesë pas pjesë.

4.

Shkruaj një përshkrim të shkurtër për shokun/shoqen tënde në një kartë të vogël.

5.

Tregoji shokut a shoqes tënde se çfarë ke bërë (nëse ai/ajo është në të njëjtën klasë) dhe ekspozoje figurën mbi bankë.



Unë e rindërtoj vendin tim të parapëlqyer

1.

Mendo në lidhje me vendin tënd të parapëlqyer. Duhet ta rindërtosh atë.

2.

Për këtë gjë duhet materiali në vijim: një kuti (ndoshta një kuti këpucësh apo një kuti tjetër), letër, ngjitës, copë lecke, gërshtë, ngjyra apo bojëra. Nëse nuk ke kuti këpucësh, mund ta krijosh me karton dhe letër.

3.

Bëj një plan se si do ta rindërtosh vendin tënd të parapëlqyer. Bëj një skicë në faqen 12.



Unë e rindërtoj vendin
tim të parapëlqyer

Kjo është skica e rindërtimit tim:

Do ta përdor këtë material:

Unë e rindërtoj vendin tim të parapëlqyer

Fleta e udhëzimeve

1.
Fillo rindërtimin e vendit tënd të parapëlqyer.


2.
Merr materialin që të duhet dhe sille atë
në bankën tënde.

3.
Kujtohu ta ndash nëse ndonjërit i duhet
i njëjti material si i yti.

4.
Puno vetë. Kur të kesh përfunduar,
shkruaj emrin mbi rindërtimin e
vendit tënd të parapëlqyer.

5.
Tregoja përfundimin e punës tënde mësuesit.

6.
Vendose mbi bankë për ekspozim
para klasës.



Unë e rindërtoj vendin tim të parapëlqyer

Fotografia/vizatimi i vendit tim të parapëlqyer

1.


Bëj me celular ose me një kamerë të zakonshme një foto të vendit tënd të parapëlqyer. Ose, mund të vizatosh një skicë të përafërt të atij vendi.

2.

Përdore fotografinë e bërë si model dhe vizato vendin tënd në një copë letre.

3.

Kujtohu ta marrësh atë me vete në shkollë.




Gurët e mi të bukur

1. Mësuesi mban dy gurë në dorën e tij dhe u lexon një vjershë fëmijëve:


Gurët e mi të bukur

Kam gjetur tre gurë
Sa të bukur e të rrumbullakët janë
Ani pse nuk duken njësoj
Me ta do të luajmë një lojë

2. Mësuesi del jashtë me fëmijët për të mbledhur gurë (tre çdo fëmijë). Kur të kthehen, përgatisin bojërat, ujin dhe furçat. Fëmijët ngjyrosin dy gurë me të njëjtën ngjyrë. Guri i tretë ka ngjyrë ndryshe. Mësuesi shkruan emrat e tyre mbi gurë me një shënues permanent. Ata luajnë lojën "Rruzull". Së pari të gjithë luajnë vetë. Guri me ngjyrë ndryshe është hedhur përballë fëmijës. Më pas dy gurët me të njëjtën ngjyrë hidhen sa më afër të jetë e mundur pranë të parit. Fëmijët luajnë në dyshe. Kush fiton? Rregullat diskutohen: Jo hedhje te fëmijët tjerë, të hidhen vetëm disa metra larg, të mos hidhen me forcë, etj.



3. Pas lojës, për rreth 15 minuta, fëmijët rrinë ulur në rreth me gurët e tyre. Ata i marrin gurët në duar. Mësuesi reciton sërish vjershën. Fëmijët e recitojnë bashkë me të.



Piktura e klasës sonë

1.

Fëmijët qëndrojnë në rreth. Mësuesi diskuton një "mozaik" me fëmijët. Ai mund të vërë copa të vogla letre në dysheme, për demonstrim.

2.

E paraqet qëllimin e të bërit një pikturë së bashku me klasën. Ai tregon që të gjithë do të bëjnë një copë të mozaikut.

3.

Ai paraqet një copë të thjeshtë letre dhe jep udhëzime: "Jeni të lirë ta bëni atë si t'ju pëlqejë. Këtu ka vetëm një rregull: Duhet të përdorni ngjyra dhe t'i vendosni ngjyrat në mënyrën që doni në pikturë. Mos vizatoni ndonjë objekt si top, kalë, etj."

4.


Fëmijët pikturojnë vetë. Mësuesi i shkruan emrat e fëmijëve në pjesën e pasme të pikturave.

5.

Mësuesi dhe fëmijët mbledhin të gjitha pikturat në një pikturë të madhe (ndoshta, mbi dysheme). Bashkë diskutojnë se si duket piktura e madhe.

6.

Mësuesi e gjen një hapësirë për ta varur pikturën e madhe (nëse është e mundur).



Në bëjmë një kometë

1.

Mësuesi i pyet fëmijët nëse e dinë se çfarë është një kometë. Ata diskutojnë dhe mësuesi jep shpjegime.


2.

Fëmijët bëjnë një kometë. Ata qëndrojnë në grupe katërshe. Në çdo grup është një prind që ndihmon.

- Çdo fëmijë merr tri fletë gazetash dhe i mbledh bashkë si lëmsh për të bërë një top të qëndrueshëm.
- Një litar dhe shirit ngjitës vendoset rreth topit disa herë për ta shtrënguar.
- Ata mund të presin shirita prej letrash me ngjyra, copash apo qesesh plastike.
- Shiritat janë mbërthyer tek topi me shirit ngjitës.
- Plastikë (prej qesesh të vjetra plasmasi) vendoset rreth topit (rreth 30 cm × 30 cm).
- Me një copë shiriti, plastika lidhet në "qafën" e kometës. Plastika e tepërt mund të pritët.
- Prindërit ndihmojnë për të shkruar emrat e fëmijëve.

3.

Hedhja e kometës: Të gjithë mund të dalin jashtë ndërtesës së shkollës. Fëmijët qëndrojnë në një vijë dhe fillojnë të hedhin kometën, pas numrimit: 1,2,3, nise!




Letra fizarmonikë

Ne jemi njëloj, ne jemi të ndryshëm

1.

Mësuesi paraqet detyrën e bërjes prej letre të klasës. Fëmijët duhet të bëjnë një "varg njerëzish prej letre". Ai tregon se si bëhet.



2.

Fëmijët me prindërit e tyre bëjnë një "varg njerëzish prej letre" dhe e ngjyrosin atë (gjithmonë dy apo katër fëmijë me një prind).

3.

Kur përfundohen vargjet, vendosen mbi bankë apo mbërthehen në dërrasën e zezë, që të shihen nga të gjithë. Mësuesi thekson faktin që të gjithë fëmijët janë të ndryshëm, por ata i përkasin bashkësisë.



Letra fizarmonikë
Ne jemi njëloj, ne jemi
të ndryshëm

